

Hapet thirrja për bursa studimi në Universitetin e Lodz, në Poloni, në kuadër të programit Erasmus +

A jeni të interesuar për të përfituar një bursë studimi në programin prestigjioz Erasmus + të Komisionit Evropian? A jeni gati për një super eksperiencë studimi ndërkombëtare? Ky është shansi Juaj. Universiteti Metropolitan Tirana u ofron mundësinë studentëve të tij të aplikojnë për bursa studimi një semestrale në Universitetin e Lodz, në Poloni.

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020 në Universitetin e Lodz.

Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT në Fakultetin e Inxhinierisë Kompjuterike dhe IT, si edhe studentët në Fakultetin e Ekonomisë:

- Viti i I, viti II dhe viti III, bachelor;
- Viti i I, viti II master.

Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Bachelor**:

- Application form (në gjuhën angleze, e gjeni bashkëngjitur);
- Kopje e pasaportës;
- Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose dokument që vërteton njohuritë në këtë gjuhë. Niveli i kërkuar B2;
- Dokumenti Learning Agreement*;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash dhe vërtetim studenti (bëni kërkesën tek Zyra e Shërbimit të Studentit në adresën support@umt.edu.al dhe ne e bëjmë gati për ju).

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

- Application form (në gjuhën angleze, e gjeni bashkëngjitur);
- Kopje e pasaportës;
- Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose dokument që vërteton njohuritë në këtë gjuhë. Niveli i kërkuar B2;
- Dokumenti Learning Agreement*;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash dhe vërtetim studenti e nivelit master (bëni kërkesën tek Zyra e Shërbimit të Studentit në adresën support@umt.edu.al dhe ne e bëjmë gati për ju).
- Listë notash dhe fotokopje e diplomës të nivelit bachelor.

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Lodz lëndë të ngjashme me ato që do të kryenit në semestrin e dytë të vitit akademik 2019/2020 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohenit në fakultetin

tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin “sending university” firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: http://umt.edu.al/docs/attach/learning-studies_en.docx. Gjithashtu e gjeni edhe bashkëngjitur.

Për më shumë informacion mbi programin e studimit të ofruar nga Universiteti i Lodz vizitoni <http://iso.uni.lodz.pl/erasmus/programmes/>

Afati për aplikim: **20 Janar 2020, ora 13.00.**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën eelmazi@umt.edu.al ose dorazi në Drejtorinë e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: eelmazi@umt.edu.al ose vizitoni <https://iso.uni.lodz.pl/erasmus/>

UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!